

VENDIM
Nr. 93, datë 6.10.2014

PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES TË SHOQËRISË SA'GA-MAT"
SHPK NGA HEC-ET "GERMAN 1", "GERMAN 2", "GERMAN 3" DHE "GERMAN 4",
ME FUQI TOTALE
4.98 MW

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa "I", 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 3 pika 1 germa "P", të ligjit nr. 138/2013, datë 2.2.2013, "Për burimet e energjisë së rinovueshme"; nenit 9 pika 1 dhe pika 2 germa "a" të "Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 6.10.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Sa'Ga-Mat" sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues nga HEC-et "German 1", "German 2", "German 3" dhe "German 4", me fuqi totale 4.98 MW,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria "Sa'Ga-Mat" sh.p.k. është plotësuar konform "Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat "a", "b", "c", "d"

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gjerat "a", "b", "c", "d"

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, gjerat "a", "b", "c"

Përshkrimi i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të kualifikojë impiantin prodhues të shoqërisë "Sa'Ga-Mat" sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie nga HEC-et "German 1" me fuqi 1,2 MW, "German 2" me fuqi 1,68 MW, "German 3" me fuqi 1,29 MW dhe "German 4" me fuqi 0,81, me fuqi totale 4.98 MW për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti